



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:012888
Datë: 01.10.2024
Numri i dokumentit: 06233196

C.nr.308/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Taulant Rexhëbeqaj dhe bashkëpunëtorin profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit M.B. me numër personal nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve; Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët e saj S.K. etj., nga Prishtina, kundër të paditurës, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të (trembëdhjetë), vlera e kontestit 942.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 01.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit M.B. nga Prizreni, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me të cilën ka kërkuar që të *“detyrohet e paditura, që paditësit, në emër të kompensimit të pagave të 13-ta (trembëdhjeta), për vitet 2021, 2022 dhe 2023, t’ia paguajë shumën prej 942.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila llogaritet nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm” e pa bazuar.*

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi M.B. Prizreni, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate, nëpërmjet shërbimit postar me datë 12.01.2024, ka paraqitur padi kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt të padisë kompensimi i pagave së trembëdhjeta për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, për më shumë se 37 vite në Spitalin Rajonal në Prizren. E paditura Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal i Prizrenit, pavarësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale, të datës 12.06.2018, nuk e ka bërë kompensimin e pagave të 13-ta, për vitet 2021, 2022 dhe 2023. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që paditësit në emër të kompensimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2021, 2022

dhe 2023, t'ia paguaj shumën prej 942 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Gjithashtu ka theksuar se paditësi marrëdhënien e punës në SPZ e ka filluar me datë 16.02.1985, ku edhe vazhdon të punojë. Duke konsideruar se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar për faktin se bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale neni 17 pika 2, e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje, kërkesën për kompensimin e pagave të 13-ta, e kanë kundërshtuar për faktin se nuk kanë mundësi buxhetore për plotësimin e kësaj kërkesë, për shkak të mjeteve të kufizuara buxhetore. Pra Kontrata Kolektive Sektoriale nuk e obligon punëdhënësin që ta bëjë kompensimin e pagave të 13, por thekson se ky obligim mund të përmbushet në bazë të mundësive buxhetore që i ka punëdhënësi. Gjithashtu kërkesëpadija është e bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale, të cilës i ka përfunduar afati kohor me datë 12.06.2021, andaj si e tillë paditësit nuk i takon e drejta për kompensimin e pagave të 13-ta. Tutje ka shtuar se e drejta për kompensimin e pagës së 13-të është parashkruar, sipas nenit 87 të Ligjit Punës dhe për këtë arsye ka kërkuar që gjykata të merr vendim dhe padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar. Përgjigjes në padi ia ka bashkangjitur kontratën e punës të lidhur në mes të palëve ndërgjyqëse dhe njoftimin nga Zyra Ligjore e SHSKUK me numër të protokollit 3823, të datës 21.12.2023.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga e paditura, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, kjo sepse nga faktet e treguara në padi, dhe prapësimet e ngritura nga e paditura në përgjigjen në padi rezulton qartazi se kërkesëpadija e paditësit është e **pa bazuar**.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren për kohë të pacaktuar fakt i cili gjen mbështetje edhe në Kontratën Kolektive nga e paditura dhe se paga bazë e të njëjtit është 314.00 euro. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është nëse paditësit i takon e drejta për kompensimin e pagës së (13) trembëdhjetë. Nga kontrata e punës me numër të amzës 168, e lidhur ndërmjet paditësit M.B. dhe të paditurës Spitali Përgjithshëm Dr. Daut Mustafa në Prizren, u vërtetua se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës. Ky fakt u vërtetua edhe nga lista e pagave, ku vërtetohet se paga bazë që paditësi e realizon është në lartësi prej 314 euro.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018, deri më datë 10.06.2021. Me nenin 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, është paraparë se *“punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13-të (trembëdhjetë), për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës si: kontrata e punës me numër 168, listën e pagave me numër EM00037178, të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet. Kjo pasi që kërkesa e paditësit ka të bëjë me kompensimin e pagës së 13-të, për vitin 2021, 2022 dhe 2023, ndërsa Kontrata Kolektive Sektoriale, në të cilën paditësi e ka bazuar kërkesën e tij për kompensimin e pagës së 13-të, për

këto vite, nuk ka qenë në fuqi. Bazuar në nenin 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, është paraparë se *“punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13-të (trembëdhjetë), për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*, e që gjykata vlerësoi se sipas kësaj kontrate është paraparë që e paditura mund t’ia kompensoj paditësit pagën e 13-të (trembëdhjetë), për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, ndërsa bazuar në Mendimin Juridik për shpërblimin jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të datës 27.02.2023, në pikë V, përcaktohet që kontrata kolektive sektoriale, aplikohet për periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021.

Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 212/2023, të datës 09.10.2023, përcaktohet në mënyrë shprehimore se çështja e kompensimit të pagës së 13-të (trembëdhjetë) për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, respektivisht nëse ka mjete buxhetore. Pra, e drejta e punëmarrësit (paditësit) për të realizuar pagën e 13-të (trembëdhjetë), krijohet kur punëdhënësi (e paditura) nuk e përmbushë atë, ndërsa nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Në fund, është në barrën e punëdhënësit që të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e një kërkesë të tillë.

Sipas vlerësimit të gjykatës dispozitat lartcekura të kontratës kolektive sektoriale lidhur me pagesën e pagës së 13-të, nuk janë norma të karakterit detyrues, andaj është plotësisht në vullnetin e punëdhënësit që duke vlerësuar mundësitë buxhetore, të i kompensohet paga e 13 punëtorit. Në rastin konkret, gjykata vendosi që ta refuzojë kërkesën për kompensimin e pagës së 13-të sa i përket vitit 2021, pasi që pretendimet e të paditurës në lidhje me mungesën e mundësive buxhetore për kompensimin e tillë, gjykata i morri si të bazuara pasi që nga provat bashkangjitur padisë, rezultoi që e paditura nuk ka pasur mundësi buxhetore realizimin e pagave të rregullta nga buxheti për paga dhe mëditje që do të thotë se ka qenë në deficit buxhetor, andaj gjykata duke pasur parasysh nenin 7 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, në këtë rast duke marrë parasysh faktin se kompensimi i tillë është i lidhur me planifikimin buxhetor të të paditurës, e në rastin konkret paditësi ka dështuar të ofrojë prova për t’i vërtetuar mundësitë për kompensimin e tillë.

Në anën tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, kishte dorëzuar si provë materiale, njoftimin e datës 21.12.2023, me numër protokollit 3823, lëshuar nga drejtori Financiar / ekspert i ekonomik dhe menaxhmentit shëndetësor në kuadër të SHSKUK. Përmes këtij njoftimi, gjykata ka vërtetuar faktin vendimtar në këtë çështje, e që është se pala e paditur, në periudhat në të cilat pala paditëse, kishte kërkesa për pagat e 13 – ta të pa paguara, në fakt ka qenë në deficit buxhetor. Tutje, përmes këtij njoftimi vërtetohet se në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, e paditura, në vitin 2021, si buxhet fillestar për këtë kategori kishte shumën prej 56,076,877.00 euro, e nga të cilat ishin shpenzuar 73,825,422.00 euro, e që diferenca në këtë vit paraqitet të jetë -17,748,544.00 euro.

Këtij njoftimi, gjykata i ka falë besimin në tërësi, sepse i njëjti është i lëshuar nga një organ zyrtar shtetëror e me të cilin u vërtetua fakti vendimtar dhe përcaktues. Arsye tjetër se pse gjykata i ka falur besimin në tërësi këtij njoftimi, është nga shkakut se të dhënat financiare, përkatësisht kategoria për paga dhe mëditje e përcaktuar, për vitin 2021, gjen mbështetje në ligjin nr. 07/l-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, konkretisht në tabelën nr. 3.1 Buxheti i Nivelit Qendror, ku për kategorinë për paga dhe mëditje ishin paraparë në shumën prej 56,076,877.00 euro. Sipas nenit 12 të këtij Ligji, par. 6

përcaktohet ndër të tjera se shpenzimi i parave publike nga kategoria e për mallra dhe shërbime, nuk është i lejuar për pagesën e punëtorëve, qoftë në formën e shtesave.... Përmes kësaj kuptojmë, se edhe sikur e paditura të kishte pas suficit buxhetor në këtë linjë tjetër buxhetore, e ka të ndaluar që të bëjë kompensimin për kategorinë e kërkuar nga pala paditëse. Sipas nenit 2, këto dispozita ligjore janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre që bien në fushëveprimin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021

Andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar e duke u nisur nga fakti se vërtetoi se në bazë të mundësive buxhetore të të paditurës nuk ishte e mundur për ta përmbushur këtë detyrim dhe atë për vitin 2021, si dhe kërkesa e paditësit Mahir Bojaxhiu, për kompensimin e pagës së 13-të, për vitin 2022 dhe 2023, është e mbështetur në një kontratë e cila nuk ka qenë në fuqi në këto periudha, e duke iu referuar nenit 399 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, kjo gjykatë e mori në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 143 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.308/2024, datë 01.10.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën